

METODOLOGJIA E ZBATIMIT TE PUNIMEVE

METODOLOGJIA E ZBATIMIT TË PUNIMEVE

Objekti:

"Përmirësimi i banesave ekzistuese për familjet përfituese"

I. QËLLIMI

Kjo metodologji përcakton mënyrën e organizimit, administrimit dhe realizimit të punimeve të rehabilitimit të banesave ekzistuese. Qëllimi i saj është të sigurojë që të gjitha punimet të zbatohen në mënyrë të organizuar, në përputhje me preventivin, specifikimet teknike, kushtet teknike të zbatimit të punimeve të ndërtimit dhe standardet në fuqi, duke garantuar cilësi, siguri dhe respektim të afateve kontraktore.

Punimet do të realizohen duke minimizuar ndikimin në jetën e përditshme të familjeve përfituese dhe duke ruajtur integritetin e pjesëve të banesës që nuk janë objekt ndërhyrjeje.

II. ORGANIZIMI I KANTIERIT

Përpara fillimit të punimeve kontraktori do të organizojë kantierin në mënyrë që të garantojë zhvillimin normal të procesit të punës.

Organizimi i kantierit do të përfshijë:

- dorëzimin e sheshit të punimeve;
- vendosjen e tabelës së objektit;
- vendosjen e sinjalistikës së sigurisë;
- krijimin e ambienteve për magazinimin e materialeve;
- sigurimin e mjeteve dhe pajisjeve të punës;
- sigurimin e energjisë elektrike dhe ujit për nevojat e kantierit;
- caktimin e zonave për depozitimin e përkohshëm të mbetjeve.

Materialet do të ruhen në kushte që shmangin dëmtimin e tyre nga lagështia, reshjet ose faktorë të tjerë atmosferikë.

III. FAZA E PARË – PËRGATITJA E PUNIMEVE

Pas marrjes në dorëzim të objektit do të kryhen:

- verifikimi i gjendjes ekzistuese;

METODOLOGJIA E ZBATIMIT TE PUNIMEVE

- matjet në terren;
- kontrolli i preventivit;
- identifikimi i zonave të dëmtuara;
- vendosja e masave mbrojtëse për banorët dhe objektin.

Do të mbulohen ose mbrohen elementët që nuk janë pjesë e ndërhyrjes, në mënyrë që të shmangen dëmtimet gjatë punimeve.

IV. FAZA E DYTË – PUNIMET E PRISHJES

Punimet e prishjes do të kryhen me kujdes për të mos dëmtuar elementët që do të ruhen.

Kjo fazë përfshin:

- heqjen e çatisë ekzistuese;
- çmontimin e elementeve prej druri të dëmtuar;
- prishjen e tavaneve të amortizuara;
- heqjen e suvatimeve të dëmtuara;
- çmontimin e dyerve të amortizuara;
- heqjen e pllakave të dëmtuara;
- çmontimin e instalimeve elektrike që do të zëvendësohen.

Materialet e dala nga prishja do të ngarkohen dhe transportohen në vendgrumbullimet e miratuara.

Zona e punimeve do të pastrohet vazhdimisht për të shmangur grumbullimin e mbetjeve.

V. FAZA E TRETË – RIKONSTRUKSIONI I ÇATISË

Pas përfundimit të prishjeve do të fillojë rikonstruksioni i çatisë.

Punimet do të realizohen sipas kësaj radhe:

- kontrolli i elementeve mbajtëse;
- montimi i konstruksionit të ri prej druri;
- vendosja e dërrasave;
- vendosja e membranës hidroizoluese;
- montimi i tjegullave;
- vendosja e kapakëve;
- montimi i ulluqeve.

Gjatë kësaj faze do të kontrollohen vazhdimisht:

METODOLOGJIA E ZBATIMIT TE PUNIMEVE

- pjerrësia e çatisë;
- drejtimi i trarëve;
- fiksimi i elementeve;
- cilësia e lidhjeve.

VI. FAZA E KATËRT – PUNIMET E HIDROIZOLIMIT

Hidroizolimi do të realizohet vetëm pasi të jetë përfunduar konstruksioni i çatisë.

Sipërfaqja duhet të jetë:

- e pastër;
- e thatë;
- pa pluhur;
- pa mbetje.

Membrana do të vendoset sipas rekomandimeve të prodhuesit dhe mbivendosjet do të kontrollohen në mënyrë që të mos krijohen pika depërtimi të ujit.

Pas përfundimit do të kryhet kontroll vizual i gjithë sipërfaqes.

VII. FAZA E PESTË – TAVANET DHE SUVATIMET

Punimet do të kryhen në këtë rend:

- pastrimi i sipërfaqeve;
- vendosja e rrjetës metalike;
- fiksimi mekanik;
- suvatimi;
- nivelimi;
- fino.

Pas tharjes do të kontrollohen:

- rrafshësia;
- aderenca;
- mungesa e çarjeve;
- përfundimi estetik.

VIII. FAZA E GJASHTË – PUNIMET E DYSHEMEVE

METODOLOGJIA E ZBATIMIT TE PUNIMEVE

Në ambientet ku është parashikuar ndërhyrja do të kryhen:

- pastrimi i bazamentit;
- nivelimi;
- vendosja e ngjitësit;
- shtrimi i pllakave;
- fugatimi;
- pastrimi.

Çdo pllakë do të kontrollohet për nivel dhe aderencë.

IX. FAZA E SHTATË – PUNIMET E DYERVE

Dyert e reja do të montohen pasi të kenë përfunduar suvatimet.

Do të kontrollohen:

- vertikaliteti;
 - funksionimi i menteshave;
 - mbyllja e bravës;
 - izolimi.
-

X. FAZA E TETË – INSTALIMET ELEKTRIKE

Punimet do të realizohen sipas projektit dhe preventivit.

Procesi përfshin:

- vendosjen e tubave;
- kalimin e kablllove;
- montimin e prizave;
- montimin e çelësave;
- montimin e panelit elektrik;
- montimin e ndriçuesve.

Në përfundim do të kryhen prova funksionale për të verifikuar funksionimin e rrjetit.

XI. FAZA E NËNTË – BOJATISJA

Bojatisja do të realizohet vetëm pasi të kenë përfunduar të gjitha punimet e tjera.

METODOLOGJIA E ZBATIMIT TE PUNIMEVE

Procesi përfshin:

- pastrimin;
- stukimin;
- smerilimin;
- astarin;
- dy shtresa bojë hidromat.

Do të kontrollohet uniformiteti i ngjyrës dhe cilësia e sipërfaqes.

XII. PASTRIMI DHE DORËZIMI I OBJEKTIT

Pas përfundimit të punimeve kontraktori do të:

- largojë të gjitha mbetjet;
- pastrojë ambientet;
- sistemojë zonën përreth objektit;
- dorëzojë objektin në gjendje të gatshme për përdorim.

Dorëzimi do të bëhet në prani të Autoritetit Kontraktor dhe mbikëqyrësit të punimeve, pas verifikimit të përputhshmërisë së punimeve me preventivin, specifikimet teknike dhe kontratën

Punoi: Ing. Blerina Mazari